

## **INSTITUTI KERKIMEVE VETERINARE**

**“BILAL GOLEMI”(IKV)**

**Rugë “Aleksander Moisiu” Nr. 10 TIRANE**

**Tel/ Fax: + 355 43 729 12**

**Tel : + 355 43 729 11**

**E.mail: [instvet@icc.al.eu.org](mailto:instvet@icc.al.eu.org)**

### **Krijimi i institutit**

**Berthama e pare e IKV konsiderohet laboratori i ngritur ne vitin 1928 nga Dr. Bilal Golemi.**

IKV u krijuar me V.K.M Nr. 86 Dt. 18. 06. 1969, mbi bazen e Stacionit Qendror Veterinar. Ne baze te ketij vendimi IKV ka per detyre:

- Te drejtoje dhe thelloje punen kerkimore shkencore qe kryhet ne lemin veterinarise.
- Te persose dhe forcoje me tej masat ne drejtim te gjurmimit dhe luftimit te semundjeve infektive e parazitare.
- Te persose dhe forcoje me tej masat per pergatitjen e biopreparateve me efektivitet te larte profilaktiv dhe kurativ

Ne baze te Ligjit Nr. 7674 Dt. 23.02.1993 “Per sherbimin dhe inspektoratin veterinar”, IKV-ja ka per detyre:

- Te kryeje pune kerkimore shkencore, me shpenzime qe perballohen nga shteti.
- Te kontrolloje gjendjen epizootike te vendit.
- Te prodhoje biopreparate dhe produkte te tjera biologjike veterinarare dhe farmaceutike.
- Te diagnostikoje semundjet e te percaktoje edhe masat e luftimit per semundjet infektive dhe parazitare ne shkalle kombetare.
- Te kontrolloje produktet dhe nen produktet ushqimore me origjine nga kafshet te produhuara ne vend si dhe ato qe importohen dhe eksportohen, si dhe te percaktoje edhe normat perkatese per kete qellim.
- Instituti ka ne vartesi teknike dhe metodike laboratoreve veterinarare te rretheve dhe laboratoreve e industrise ushqimore qe kryjne analiza veterinarare.

**Instituti i Kerkimeve Veterinare eshte e vetmja Qender e References Veterinare ne territorin e Republikes se Shqiperise.**